# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-462960**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | PD mbledh kryesinë në mbrëmje, merret VENDIMI për qëndrimin politik ndaj Ramës pas skandalit me Vlora Hysenin |
| ADRESA | `https://newsbomb.al/politike/pd-mbledh-kryesine-ne-mbremje-merret-vendimi-per-qendrimin-politik-ndaj-i401926` |
| BURIMI | newsbomb.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:54:39 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 17:44:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `83b0789f0a43ef2d055038ae2a61a33a7e74f2fe49f85b331a47cb9430bd8080` |
| TEKSTI | `e2e8009b3bc60bfe76800432e671d106edfafdb2b79255088e67d7b4505729c0` |
| PAMJA | `89e9ef423cc264e6818964c3281f63e33ff86a15f34440997d8d36bc085d7c87` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `1576a060c3a3422335345a64d8add443a659cb23d121ac34ffa38f56976a0047` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/1576a060c3a3422335345a64d8add443a659cb23d121ac34ffa38f56976a0047`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Hapësire reklamuese



Politikë

23 Shtator 2026, 19:44

# PD mbledh kryesinë në mbrëmje, merret VENDIMI për qëndrimin politik ndaj Ramës pas skandalit me Vlora Hysenin

Shkruar nga **Newsbomb**




**Vlora Hyseni, Edi Rama, Sali Berisha**

Pas mbledhjes së Grupit Parlamentar, mbrëmjen e sotme kryedemokrati Sali Berisha ka mbledhur Kryesinë dhe sekretariatet e Partisë Demokratike.

Në fjalën e mbajtur nga mbledhja e kryesisë pasditen e kësaj të mërkure, ku siç u njoftua do të merrej një vendim lidhur me arrestimin e shefes së SHISH-it, lideri demokrat Sali Berisha theksoi për simpatizanët e tij se është momenti që ai dhe demokratët të luftojnë me të gjitha mjetet demokratike për largimin e Ramës.

*"Sot lipset që PD të ndërmarrë gjithë përpjekjet e saj për largimin e Ramës dhe regjimit të tij. Për përmbysjen e këtij regjimi. Koha fton sot çdo demokrat dhe demokrate, të gjithë mbështetësit tanë, të ngrihen në këmbë dhe me të gjitha mjetet demokratike të përballen me këtë regjim."*, tha sot Berisha.

Më tej, kreu i PD-së rrëzoi idenë e bojkotimi të punimeve në Kuvend duke shtuar se ky veprim do të përbënte avantazh për kryeministrin Edi Rama. Ndërsa shtoi se grupi parlamentar i PD-së do i japë përgjigje të forta në Kuvend.

*"Vendimi më i lehtë do të ishte bojkoti i parlamentit, por unë kam qenë dhe mbetem i bindur se ky do të ishte avantazh për Edi Ramën, do të përbënte avantazh për Ramën.*

Revista




Abonohu tani dhe lexoje

## Lajmet e fundit


Bota
Rusia godet qendrat e të dhënave në Kiev, ndërpritet interneti për 100 mijë familje


Aktualitet
GJKKO e do në burg për trafikimin e dhjetërave ton kokainë, PRANGOSET në Rusi i shumëkërkuari Shpëtim Aliu, "shoku" i Eldi Dizdarit pritet t'i dorëzohet Shqipërisë (DETAJE)

Zbulo më shumë artikuj

*Çdo njeri nga ne ta ketë të qartë se ai lufton për ekzistencën e tij, pasi e di që s'ka vend tjetër veçse në qeli me dhjetëra vite burg për krimet që ka kryer. Ai është i aftë për gjithçka për të ruajtur pushtetin dhe karrierën e tij.*

*Grupi parlamentar do të përshtatet për t'i dhënë përgjigjen e merituar. Ne në parlament jemi në kushte të vështira, por ne duhet t'i japim përgjigjet më të forta në parlament."*, shtoi më tej Berisha në fjalën e mbajtur nga kryesia.

Gjatë fjalës së tij Berisha po ashtu akuzoi se Hyseni ka vendosur në dispozicion të grupeve dhe organizatave kriminale, por edhe të armiqve të NATO-s, të dhëna me rëndësi të siguruara nga Shërbimi Informativ Shtetëror.

Këshilluar për ty



**SPAK zbardh kërkesën: Shefja e SHISH do të merret në pyetje mesditën e nesërme, dy të tjerët në orën 9 të mëngjesit (DETAJE)**

---

*"Grupi mafioz i AKSHI-t është grupi mafioz më i rrezikshëm në Evropë sepse ai vendosi me urdhër të Edi Ramës, në kontroll të plotë dhe total, internetin dhe komunikimin me internet për shqiptarët dhe të huajt në territorin e Republikës së Shqipërisë. Një akt i pashembullt. Vendosi të gjitha këto të dhëna në dispozicion të grupeve dhe organizatave kriminale, por edhe të armiqve të NATO-s, armiqve të Shqipërisë dhe armiqve të partnerëve tanë"*, shtoi Berisha.

Në përmbyllje të fjalës së tij, lideri demokrat shtoi më tej se Vlora Hyseni, është një anëtare e krimit të organizuar.

*"Njeriu, që përfaqësonte Shqipërinë në partneritetin më të rëndësishëm, më delikat, më serioz, partneritetin me shërbimet e vendeve mike, rezulton se ishte një anëtare e grupeve më të rrezikshme mafioze kriminale. Rezulton se ajo ishte e padenjë për asnjë lloj besimi"*, përfundoi Berisha.

Nga ana tjetër, qytetarët janë bërë sërish bashkë në ditën e 116-të të protestës, ku ashtu si prej më shumë se tre muajsh kërkojnë me këmbëngulje ndryshim rrënjësor të klasës politike, përfshirë këtu demokratë e socialistë.

Me thirrjet e zakonshme, të cilat kanë "buçitur" Tiranën prej më shumë se 3 muajsh **"Rama burg, Berisha burg!"** qytetarët kërkojnë revolucion.

*"Kërkojmë revolucion. Jemi kundër këtij sistemi, na kanë zhgënjyer"* shprehen qytetarët në fjalimet e tyre të mbajtura sot para Kryeministrisë.

## Sondazh

Poll

## Lexo gjithashtu



E Mërkurë 20:16 Newsbomb

## “Shteti i gysrave!” Salianji "shpërthen" pas arrestimit të shefes së SHISH: Qeveria e Ramës ka ulur pantollonat para krimit (REAGMI)



Politikë

Klodiana Lala paralajmëron nga zyra e Fevziut: Mbaje shënim, do dalin të dhëna që s'i kishte imagjinuar ndonjëherë

E Mërkurë 14:08



Politikë

Reforma territoriale: 3,500 qytetarë u dëgjuan, Mazniku: Bashki më të forta, shërbime më cilësore dhe më shumë mundësi nga fondet e BE-së

E Mërkurë 13:35




E Mërkurë 13:08

## Ish-kreu i SPAK ia firmosi masat e sigurisë, gazetari jep detaje: Vlora Hyseni pinte kafe njëherë në javë me Altin Dumanin...



Politikë

Akuzat e opozitës, ministrja Spahiu pret në zyrë qytetarin: Rastin e Albi Sulës do ta ndjekim në Turqi! Mos bëni politikë me shëndetin e tij

E Mërkurë 11:39



Politikë

“Ka rënë shteti, Kuvendi flet për s*ksin e engjëjve”, përplasje te “Ligjet” pas skandalit me SHISH-in, demokratët kërkojnë mbledhjen e Këshillit të Sigurisë

E Mërkurë 11:06





E Mërkurë 10:08

## Një ditë pas goditjes së SPAK ndaj SHISH-it, demokratët mblidhen në seli, Berisha thërret Kryesinë e re



Politikë

Balla dhe Tarquinio dalin me DEKLARATË për takimin dyditor për anëtarësimin në BE: Gati deri në fund të 2027

E Martë 17:08 Newsbomb



Politikë

"Edi Rama të kthehet nga Amerika dhe të japë dorëheqjen", Erald Kapri kërkon që vendi të shkojë në zgjedhje: Sot shteti ka rënë, jemi turpëruar!

E Martë 15:27




E Martë 13:25

## Besmir Veli: Histori, kulturë, tradita, kulinari, natyrë...i gjeni të gjitha këtu në Delvinë



Politikë

Kthimi i Edi Ramës nga Amerika, Flamur Noka thirrje SPAK pas akuzave




Politikë

Sali Berisha flet për takimet e Vlora Hysenit dhe Ergys Agasit: Darkonin te




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.